



## OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT

Data: 07.04.2026

Drejtuar:

**Operatorit Ekonomik (OE)**  ose

Pastrime Silvio shpk

Nipti: K91413010N

Adresa: Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga Fatmir Haxhiu, Pallati 2, Shkalla 10, Apartamenti 76, Kati I, Tiranë.

**Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)**

- **OE/BOE me nënkontraktor**

**PO**  **JO**

- **OE/BOE me Subjekt Mbështetës:**

**PO**  **JO**

\* \* \*

Tipi i Kontratës: *Shërbime*

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar, marrëveshje kuadër

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF-76135-02-13-2026**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Shërbim i pastrimit të ambienteve të jashtme në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza, Tiranë”**

**Fondi limit: 38,247,344.10** (tridhjetë e tetë milion e dyqind e dyzet e shtatë mijë e treqind e dyzet e katër pikë dhjetë) **lekë, pa TVSH ose 396,551** (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e një) euro pa tvsh.

Referuar kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë datë 13.02.2026 (96.45 lekë/euro).

**Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj:** 24 (njëzet e katër) muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 16.02.2026

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike Nr. 16 datë 23 Shkurt 2026

#### **KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Formulari bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. Operatori ekonomik ALPEN PULITO shpk

NIPT K61516506H

Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë) [www.obp.al](http://www.obp.al)

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 37,955,520.45 (tridhjetë e shtatë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e njëzet pikë dyzet e pesë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO X

2. Operatori ekonomik Pastrime Silvio shpk NIPT K91413010N  
Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 36,911,383 (tridhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO x

3. Operatori ekonomik S I L V E R shpk NIPT K88010301S  
Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 34,503,996.00 (tridhjetë e katër milion e pesëqind e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO x

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:**

1. Operatori ekonomik ALPEN PULITO shpk NIPT K61516506H  
Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 37,955,520.45 (tridhjetë e shtatë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e njëzet pikë dyzet e pesë) lekë pa TVSH.

*Arsyet:*

Operatori ekonomik "ALPEN PULITO" shpk me NUIS K61516506H, me subjekt mbështetës "LEKA -2007" shpk me NUIS K77929501L, me dokumentacionin e paraqitur vërteton se nuk i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit si më poshtë:  
OE nuk plotëson Pikën 2.3.7 të KVK, ne te cilën është kërkuar: "Operatori ekonomik, duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme:

- 1 (nje) autobot uji me kapacitet jo më të vogël se 7000-8000 litra;
- 1 (nje) pompe me presion/ tub uji te lidhur me cisterne/ makine per trotuare apo kende te veshtira;
- 2 (dy) mjete teknologjike transportuese te mbetjeve urbane, me kapacitet minimal 5 ton, të mbyllur, të pajisur me mekanizem ngritës fundor, me ndriçim fundor dhe sinjalizues zanor;

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesin dokumentet e mëposhtme provuese:

Për Mjetet që regjistrohen në regjistrat publikë: Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion të plotë (të vlefshëm), si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje apo përdorimi dhe leje qarkullimi të mjetit, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore.

*Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, operatori ekonomik, duhet të paraqese dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me*

anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë), ku të identifikohen të dhënat teknike të tyre.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike si dhe dokumentacionit të dorëzuar në SPE, rezulton se OE “ALPEN PULITO” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Formular Përmbledhës të Vetdeklarimit të OE “ALPEN PULITO” SHPK;
- Formular Përmbledhës të Vetdeklarimit të OE (shoqërise mbështetese) “LEKA -2007 ” SHPK;

Për plotësimin e pikës së mësipërme OE ka paraqitur mjetet me të dhënat si më poshtë:

- AA 958 OR, ne pronesi te shoqerise “ALPEN PULITO” SHPK;
- AB 846 UO, ne pronesi te shoqerise mbeshtetese OE “LEKA -2007” SHPK;
- AB 079 GH, ne pronesi te shoqerise mbeshtetese OE “LEKA -2007” SHPK;
- AA 026 DR, ne pronesi te shoqerise mbeshtetese OE “LEKA -2007” SHPK;

Në rastin konkret operatori ekonomik “ALPEN PULITO” shpk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit konkretisht në seksionin përkatës në pikën B, “Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik” si subjekt mbështetës operatorin ekonomik “LEKA -2007” shpk, lidhur me plotësimin e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.7 të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë.

Bazuar në pikën 4 të nenit 90 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar ku është përcaktuar qartë se: 4. Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.” Referuar parashikimeve më sipër duhet që operatori ekonomik “ALPEN PULITO” shpk si operator ekonomik që mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera të plotësojë 50% të kërkesës së përcaktuar në pikën 2.3.7 të kapacitetit profesional të operatorëve ekonomikë ndërkohë rezulton se “ALPEN PULITO” të jetë mbështetur me shume se 50% te subjekti mbështetës “LEKA -2007” SHPK e cila bie ndesh edhe e parashikimet e dispozitës më sipër.

Nga sa më lartë OE skualifikohet për mopërmbushje të kriterëve të vecanta për kualifikim pika 2.3.7.

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

2. Operatori ekonomik S I L V E R shpk

NIPT K88010301S

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 34,503,996.00 (tridhjetë e katër milion e pesëqind e tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Arsyet:

Operatori ekonomik “S I L V E R” shpk me NUIS K88010301S, me dokumentacionin e paraqitur vërteton se nuk i përmbush kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit si më poshtë:

- a) Në dokumentet e tenderit, shtojca 9 “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit”, te procedurës së prokurimit, është kërkuar si më poshtë vijon:

## **“2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;”

Në seksionin 3 të Njoftimit të Kontratës në dokumentet e tenderit, te procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike

**3.1 Sigurimi i ofertës:** (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor, në bazë të diskrecionit të tij, mund të kërkojë sigurimin e ofertës edhe për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është **764,946.8** (shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e dyzet e gjashtë pikë tetë) lekë, ose 7,931 (shtatë mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) euro.

Sa më sipër, referuar kërkesave të vendosura nga autoriteti kontraktor për sa I përket sigurimit të ofertës, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “S I L V E R” SHPK ne sistemin e prokurimeve elektronike ka paraqitur 2- Sigurim oferte pdf të leshuar nga shoqëria “Ansig” me nr. serie 16177, me vlerë 396,551 lekë.

Komisioni I Vleresimit të Ofertave gjykon se formulari i sigurimit të ofertës të paraqitur nga oferuesi, I cili është leshuar nga shoqëria e sigurimeve “Ansig”, nuk është sipas vlerës së kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe nuk i përket as 2% të vlerës së përlllogaritur të kontratës sic parashikohet dhe në nenin 83 pika 2 e ligjit “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe rrjedhimisht operatori ekonomik me dokumentacionin e dorëzuar nuk e ka plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 3.1, të dokumenteve të tenderit, pasi vlera e sigurimit të ofertave nuk është sipas përcaktimeve në Seksionin 3 të dokumenteve të tenderit.

b) Oe nuk e ka plotësuar saktë shtojcën 2 “Lista e çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit”. OE ka plotësuar në mënyrë të gabuar sainë në zërin 3:

Nr.	Përshkrimi i shërbimeve	Njësia	Sasia/ ditë	Sasia e plotësuar nga OE
3	Shërbim evadimi të mbetjeve urbane QSUNT -Landfill (2-4 herë sipas kërkesës së A.K.-së)	kg	deri 2520	<b>2800</b>

Operatori ekonomik “S I L V E R” shpk, nuk plotëson kërkesat e Seksionit I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, B. PËRGATITJA E OFERTAVE, pika 4, Formularët e tenderit dhe Listat e Çmimeve, ku citohet se “Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës Ekonomike në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqëruar duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim; nuk do të pranohet asnjë zëvendësues dhe duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar”. Konkretisht rezulton se ofertuesi në shtojcën 2 “LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT”, të paraqitur në SPE ka ndryshuar sasinë e kërkuar të artikullit me emërtesë “Shërbim evadimi të mbetjeve urbane QSUNT -Landfill (2-4 herë sipas kërkesës së A.K.-së)”, nga 2520 kg në 2800 kg dhe jo sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën 7 (FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT), të DT.

Ky vendim mbështetet në nenin 92/3, të LPP “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës ....”, si dhe pikën 18 “Përgjegjshmëria e Ofertave Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë në DST, ku përcaktohet “Nëse një ofertë nuk i përgjigjet kërkesave të Dokumenteve të Tenderit, ajo refuzohet”.

**OE skualifikohet për mospërmbushje të kriterëve të vecanta për kualifikim pika 1/b dhe për paraqitje oferte të pasaktë.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO   
\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, informojmë se, operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si ofertues i sukseshëm:

1. Operatori ekonomik Pastrime Silvio shpk NIPT K91413010N  
Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: 36,911,383 (tridhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO  JO

Totali i pikëve të marra: Nuk ka

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.